



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Plani i veprimit të KPM-së gjatë zgjedhjeve të përgjithshme në vitin 2025 në Republikën e Kosovës

Prishtinë, shtator 2024

Përmbajtja

Hyrja.....	3
Baza Ligjore	4
Juridiksioni i KPM-së	4
Kompetencat e KPM-së	5
Aktivitetet e KPM-së gjatë procesit zgjedhore	5
Periudha parazgjedhore.....	5
Periudha gjatë fushatës zgjedhore	7
Periudha pas zgjedhore	9
Burimet njerëzore dhe teknike të KPM-së.....	9
Monitorimi dhe Vlerësimi	10

Lista e shkurtesave

KPM - Komisioni i Pavarur i Mediave

KQZ - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

SPC - Subjektet Politike të Certifikuese

OSHMA – Ofruesi i Shërbimeve Mediale Audiovizuale

OSH – Operator i Shpërndarjes

Hyrja

Plani i veprimit të KPM-së për zgjedhjet e përgjithshme në vitin 2025 në Republikën e Kosovës paraqet aktivitetet që KPM-ja planifikon t'i ndërmerr gjatë zgjedhjeve të planifikuara më 2025 në bazë të mandatit ligjor të përcaktuar me Ligjin e KPM dhe Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Plani i veprimit është i ndarë në tri pjesë që përfshinë aktivitetet e planifikuara para fillimit të fushatës zgjedhore, gjatë fushatës zgjedhore dhe pas fushatës zgjedhore.

Periodha para fushatës zgjedhore përfshinë aktivitetet e KPM-së në hartimin e rregullores për sjelljen e mediave gjatë fushatës dhe heshtjes zgjedhore, si obligim i paraparë në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të miratuar në vitin 2023. Kjo periudhë përfshinë edhe aktivitetet që kanë të bëjnë me komunikimin dhe sensibilizimin e të licencuarve të KPM-së me qëllim të njoftimit rreth obligimeve të mediave gjatë këtij procesi. Aktivitet tjetër në këtë periudhë është edhe ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe teknike të Zyrës së KPM-së.

Periodha gjatë fushatës zgjedhore deri në mbylljen e vendotimeve do të përfshijë monitorimin dhe vlerësimin e pajtueshmërisë së të licencuarve të KPM-së me legjislacionin në fuqi, si dhe vendimmarrjen e shpejtë në rast të shkeljeve të identifikuar.

Ndërsa, periodha pas zgjedhore do të fokusohet në prezantimin e të gjeturave nga monitorimi i të licencuarve gjatë periudhës zgjedhore.

Në përgjithësi, zbatimi i Planit të Veprimit do të bëhet brenda një periudhe shtatë mujore, Shtator 2024 – Mars 2025. Përmes këtij Plan Veprimi, KPM ka identifikuar aktivitetet e synuara që korrespondojnë dhe ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e KPM-së gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Duke identifikuar qartë aktivitetet e nevojshme gjatë këtij procesi dhe duke i zbatuar ato, KPM do të jetë në gjendje të kryejë detyrat dhe përgjegjësitë e parapara sipas legjislacionit në fuqi.

Objektivat e KPM-së mbi procesin zgjedhor përfshijnë:

- Krijimin e akteve nënligjore të bazuara në ligj dhe konsultim publik;

- Udhëzimin e mediave të licencuara për një qasje të drejtë dhe të paanshme gjatë fushatës zgjedhore;
- Sigurimi i kushteve të barabarta dhe mos diskriminuese për qasjen e subjekteve politike të certifikuara në mediat e licencuara;
- Informimi dhe sensibilizimi i duhur i subjekteve të licencuara;
- Krijimin e kushteve të favorshme teknike për monitorim intensiv gjatë fushatës zgjedhore;
- Vendimmarrje të shpejtë dhe masa proporcionale në rast të shkeljes së legjislacionit në fuqi.

Baza Ligjore

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin Ligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, ndërsa gjatë periudhës së zgjedhjeve të Kreut VIII të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i cili përcakton në mënyrë specifike dispozitat për “Mediat gjatë Fushatës së Zgjedhjeve”, me theks zbatimin e Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/035.

Në periudhën zgjedhore, gjatë monitorimit të OSHMA-ve do të aplikohen edhe dispozitat ligjore të parapara në aktet nënligjore të KPM-së sa i përket qasjes së drejtë dhe të paanshme, mbrojtjes së fëmijëve dhe komunikimeve komerciale audiovizuale, të parapara në:

- Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/035;
- Rregulloren KPM 2023/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio dhe Audiovizuale; dhe
- Rregulloren KPM 2023/02 për Komunikimet Komerciale Audio dhe Audiovizuale.

Juridiksioni i KPM-së

Në bazë të nenit 4, paragrafi 1, të Ligjit për KPM-në, përcaktohet që KPM-ja ka juridiksion mbi ofruesit e shërbimeve mediale si vijon:

“1.1. të cilat janë të themeluara dhe që vendimet redaktuese janë nxjerrë në Republikën e Kosovës; dhe

1.2. kur ofruesi i shërbimit medial ka zyrën qendrore në Republikën e Kosovës por, vendimet redaktuese janë marrë në vendet e BE-së apo në vendet e tjera”.

Kompetencat e KPM-së

Në bazë të nenit 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, paragrafi 1, përcaktohet që:

“Komisioni i Pavarur i Mediave është organ i pavarur që rregullon spektrin e Frekuencave Transmetuese në Republikën e Kosovës, licencon transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj”.

Kompetencat e KPM-së janë të përcaktuara në bazë të nenit 3 të Ligjit për KPM-në, që në mes tjerash, përfshijnë:

Paragrafi 1: *“KPM-ja është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale”.*

Paragrafi 2.2: *“vendosjen e sanksioneve për subjektet e licencuara të cilat bëjnë shkeljen e rregulloreve të komisionit apo të kushteve dhe termeve të licencës”;*

Paragrafi 2.6: *“nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare;*

Paragrafi 2.11: *“nxjerr akte nënligjore që janë të nevojshme për zbatimin e këtij ligji”.*

Aktivitetet e KPM-së gjatë procesit zgjedhore

Periudha parazgjedhore

Në bazë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, përkatësisht nenit 48, paragrafi 2, përcaktohet që:

“Komisioni i Pavarur për Media (KPM) në pajtim me dispozitat e Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave, miraton udhëzimet për rregullimin e blerjes së kohës së emetimit nga subjektet politike në mediat transmetuese”.

Në lidhje me këtë, KPM ka planifikuar hartimin dhe miratimin e Rregullores për sjelljen e mediave gjatë fushatës dhe heshtjes zgjedhore . KPM synon që, përveç obligimit të paraparë sipas nenit 48.2, të përfshijë në këtë akt të gjitha dispozitat e aplikueshme për mediat të parapara në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme si dhe në Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.

Para miratimit, akti do t'i nënshtrohet diskutimit publik siç parashihet me ligj.

Miratimi i Rregullores për sjelljen e mediave gjatë fushatës dhe heshtjes zgjedhore				
Veprimet	Bartës i veprimit	Mbështetës i veprimit	Periudha	Fokus i aktivitetit / qëllimi
Angazhimi i ekspertit të jashtëm	Komisioni	Donatorë potencial	Shtator – Tetor 2024	Eksperti ligjor do të jetë përgjegjës për hartimin e draftit të Rregullores për rregullat e transmetimit të fushatës zgjedhore. Drafti do të përfshijë të gjitha obligimet e parapara me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore të KPM-së. Po ashtu, eksperti do të ofrojë edhe propozime rreth formave të ditareve, si shtojcë e Rregullores.
Themelimi i Grupit Punues	Komisioni	ZE	Shtator 2024	Grupi Punues do të jetë përgjegjës për rishikimin e draftit të Rregullores për zgjedhje në bashkëpunim me ekspertin ligjor dhe do t'i paraqes Komisionit të KPM-së draftin e rregullores për miratim.
Periudha e konsultimit publik	KPM	Zyrtari informim për	Tetor 2024	Drafti paraqitet për konsultim publik.
Rishikimi i draftit	Grupi punues	ZE	Pas periudhës së konsultimit publik	Grupi Punues, bazuar në komentet e ngritura gjatë periudhës së konsultimit publik do t'i paraqes Komisionit të KPM-së draftin e përgatitur që do të paraqitet në dëgjim publik.
Dëgjimi publik	KPM	ZE	Nëntor 2024	Drafti i Rregullores do të jetë subjekt i dëgjimit të hapur publik, me pjesëmarrje të të gjithë të licencuarve të KPM-së dhe palët e interesit.
Rishikimi i draftit	Grupi punues	ZE	Nëntor 2024	Grupi Punues, bazuar në komentet e ngritura gjatë dëgjimit publik, dhe në konsultim me ekspertët, do t'i paraqes Komisionit të KPM-së draftin e rregullores për miratim.
Miratimi i Rregullores	KPM	ZE	Nëntor 2024	Plotësimi i bazës ligjore të KPM-së.

Ndërsa, me qëllim të informimit dhe diskutimit rreth ndryshimeve ligjore rreth obligimeve të mediave gjatë procesit zgjedhore, KPM ka paraparë realizimit e gjashtë takimeve regjionale. Organizimi i këtyre takimeve do të mbështetet nga Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Informimi rreth ndryshimeve ligjore do të bëhet edhe nëpërmjet komunikimit përmes faqes së KPM-së dhe postës elektronike.

Komunikimi me të licencuarit e KPM-së				
Veprimet	Bartës i veprimit	Mbështetës i veprimit	Periudha	Fokus i aktivitetit / qëllimi
Takimet regjionale me të licencuarit e KPM-së	KPM	OSBE	Nëntor – Dhjetor 2024	Njoftimi i të licencuarve rreth ndryshimeve në Ligjin për Zgjedhje dhe obligimet e mediave gjatë këtij procesi
Njoftimi përmes faqes	Zyrtari për Informim	/	Nëntor-Dhjetor 2024	
Njoftimi përmes postës elektronike	Zyrtari për Informim	/	Nëntor-Dhjetor 2024	

Sa i përket kapaciteteve njerëzore, gjatë kësaj periudhe është paraparë realizimi i trajnimit për zgjedhje të stafit të Departamenteve përkatëse të KPM-së. Kjo është paraparë të realizohet përmes mbështetjes nga programi PROFREX, program i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.

Ngritja e kapaciteteve njerëzore				
Veprimet	Bartës i veprimit	Mbështetës i veprimit	Periudha	Fokus i aktivitetit / qëllimi
Trajnimi i stafit	KPM	PROFREX	Nëntor 2024	Organizimi i trajnimit për stafin e DMA dhe DL lidhur me zgjedhjet në përgjithësi, si dhe ofrimi i praktikave më të mira gjatë procesit zgjedhor.

Periudha gjatë fushatës zgjedhore

Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, është paraparë monitorimi i OSHMA-ve (TV) me karakter gjeneralistik, me transmetim tokësor dhe përmes OSH-ve. Metodologjia që do të përdoret gjatë monitorimit të performancës së ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale do të bazohet në analizë sasiore dhe cilësore, me theks të veçantë në edicionet qendrore të lajmeve, kronikat zgjedhore, pikat reklamuese politike si dhe intervista e debate në përmbajtjet programore të transmetuara gjatë fushatës zgjedhore.

Për më tepër, monitorimi i pjesës tjetër të të licencuarve, sikurse televizionet me karakter tematik dhe radiot, do të monitorohen në bazë të ankesave të parashtruara.

Monitorimi i pajtueshmërisë së OSHMA-ve me legjislacionin në fuqi				
Veprimet	Bartës i veprimit	Mbështetës i veprimit	Periudha	Fokus i aktivitetit / qëllimi
Monitorimi i përmbajtjeve programore të OSHMA-ve	DMA	Departamentet tjera përkatëse	Gjatë fushatës zgjedhore	Vlerësimi i pajtueshmërisë me legjislacionin në fuqi

Sa i përket vlerësimit të zbatimit të legjislacionit në fuqi nga ana e OSHMA-ve, bazuar në të gjeturat e monitorimit, rastet e shkeljeve gjatë kësaj periudhe, përfshirë edhe periudhën e heshtjes zgjedhore deri në mbylljen e vendotimeve, do të procedohen sipas procedurave të parapara.

Veprimet ligjore për shkeljet e mundshme				
Veprimet	Bartës i veprimit	Mbështetës i veprimit	Periudha	Fokus i aktivitetit / qëllimi
Raportet e monitorimit dërgohen tek DL për iniciimin e veprimeve ligjore për shkeljet e mundshme	DMA	/	Gjatë fushatës zgjedhore	Zbatimi i legjislacionit në fuqi
Hapja e rasteve ligjore	DL	DMA	Gjatë dhe pas fushatës zgjedhore	
Miratimi i vendimeve	Komisioni	ZE	Gjatë dhe pas fushatës zgjedhore	

Gjatë kësaj periudhe, KPM ka paraparë të ketë bashkëpunim me palët e interesit, me theks Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Bashkëpunimi dhe diskutimi i çështjeve me interes të përbashkët do të realizohet përmes organizimit të takimeve të vazhdueshme dhe kanaleve tjera të komunikimit.

Bashkëpunimi me palët e interesit				
Veprimet	Bartës i veprimit	Mbështetës i veprimit	Periudha	Fokus i aktivitetit / qëllimi
Organizimi i takimeve me palë të interesit	KPM	ZE	Gjatë fushatës zgjedhore	Bashkëpunimi i KPM-së me palët e interesit, në veçanti me KQZ-në me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore.

Periudha pas zgjedhore

Pas përfundimit të periudhës së fushatës zgjedhore, KPM ka paraparë të ndërmerr disa veprime në lidhje me prezantimet e të gjeturave nga monitorimi i mediave gjatë fushatës zgjedhore. Është paraparë që të dhënat e përpunuara nga monitorimi të prezantohen për publikun në përgjithësi, përmes publikimit në faqen e KPM-së si dhe organizimit të një konference për media.

Prezantimi i të gjeturave nga monitorimi				
Veprimet	Bartës i veprimit	Mbështetës i veprimit	Periudha	Fokus i aktivitetit / qëllimi
Përpunimi i të dhënave dhe përpilimi i raportit përmbledhës	DMA	DMA	Shkurt-Mars 2025	Hartimi i raportit përmbledhës: të gjeturat, veprimet, rekomandimet.
Publikimi i të gjeturave nga monitorimi	KPM	Zyrtari për informim	Mars 2025	Ofrimi për palët e interesit i të gjeturave nga monitorimi (përmes ueb faqes dhe të shtypura).
Organizimi i tryezës / konferencë për media	KPM	ZE	Mars 2025	Prezantimi i të gjeturave nga monitorimi për palët e interesit me qëllim të diskutimit të shkeljeve të gjetura dhe hapat për evitimin e tyre.

Burimet njerëzore dhe teknike të KPM-së

Aktualisht stafi i KPM-së përbëhet prej 30 personave. Në Departamentin e Monitorimit dhe Analizave janë të punësuar 9 persona ndërsa në Departamentin Ligjor gjithsej 6 persona.

Duke pas parasysh numrin e kufizuar të stafit të DMA-së dhe DL-së, departamente bartëse të shumicës së aktiviteteve dhe veprimeve të planifikuara, Zyra Ekzekutive ka planifikuar angazhimin e stafit edhe nga departamentet tjera të KPM-së.

Po ashtu, gjatë periudhës për zbatimin e Planit të Veprimit, stafi i KPM-së do të angazhohet edhe me punë jashtë orarit me qëllim të përbushjes dhe realizimit të aktiviteteve dhe veprimeve të planifikuara.

Sa i përket kapaciteteve teknike, për monitorim të OSHMA-ve do të përdoret sistemi i monitorimit, përmes së cilit mundësohet pranimi, incizimi dhe arkivimi i programeve të transmetuara të OSHMA-ve. Departamenti për Menaxhimin e Frekuencave dhe Menaxheri i IT-së do të angazhohen në mënyrë të vazhdueshëm të mbikëqyrjes së sistemit të monitorimit, me qëllim të evitimit të problemeve teknike që mund të shfaqen në sistem gjatë kësaj periudhe. Ndërsa, stafi i departamenteve tjera, do të angazhohet kryesisht në përpunimin e të dhënave, përfshirë ato të Ditarëve për Zgjedhje që dorëzohen nga OSHMA-të gjatë zgjedhjeve.

Në rastet kur për shkaqe teknike nuk do të ketë regjistrim të ndonjë përmbajtje të caktuar, do të kërkohet arkiva nga OSHMA-të përkatëse. Në bazë të kushteve dhe termeve të licencës, OSHMA-të e licencuara nga KPM janë të obliguar të ruajnë arkivën e programit të transmetuar deri në 21 ditë.

Monitorimi dhe Vlerësimi

Kryeshefi Ekzekutiv do të jetë përgjegjës për koordinimin dhe vlerësimin e realizueshmërisë së aktiviteteve dhe veprimeve të planifikuara si dhe identifikimit të rreziqeve dhe sfidave të mundshme që mund të paraqiten dhe ndikojnë në realizimin e tyre.

Kryeshefi Ekzekutiv do të raportojë në mënyrë të vazhdueshëm tek Komisioni rreth realizimit të aktiviteteve si dhe do të ofrojë rekomandime në rastet kur paraqiten vështirësi në realizimin e tyre.



KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

Rr. Perandori Justinian Nr. 124, Qyteza Pejton 10000, Prishtinë, Kosovë.

Tel.: +383 38 245 031

e-mail: info@kpm-ks.org